



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit
P-086

Prishtinë, më 4 prill 2017, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 PRILL 2017

Në mbledhje morën pjesë: Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Slobodan Petroviq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Zenun Pajaziti, Ismet Beqiri, Albulena Haxhiu, Pal Lekaj, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga OSBE-ja: Saniye Berisha dhe
Nga EUSR-ja: Blerta Bejtullahu.

Mbledhjen e drejtoi Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Nënkryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohet edhe një (1) pikë shtesë, të cilën e miratoi Kryesia e Kuvendit.

Kryesia, me propozimin e nënkryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
2. Caktimi i datës për mbajtjen e seancës plenare dhe
3. Kërkesa e deputetit Bardhyl Meta për mbështetje financiare për shërim jashtë vendit.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë së Kuvendit, e mbajtur më 27 mars 2017.

2. Caktimi i datës për mbajtjen e Seancës plenare

Kryesuesi i njoftoi të pranishmit me pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 mars 2017, si dhe për seancën plenare të caktuar nga Kryesia e Kuvendit për datën 31 mars 2017, e cila nuk i ka filluar fare punimet, ngase seanca paraprake i ka vazhduar punimet edhe më 31 mars 2017.

Kryesia, pasi diskutoi për pikat e papërfunduara nga seanca e mëparshme, si dhe për caktimin e datës për mbajtjen e seancës plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që Kuvendi të mbajë seancë plenare më 11 prill 2017, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

I. Pikat e papërfunduara nga seanca plenare, e mbajtur më 30 dhe 31 mars 2017

1. *Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet,*
2. *Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes Vetëvendosje,*
3. *Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve penale,*
4. *Rundi i dytë i votimit për zgjedhjen e një (1) anëtari të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nga radha e komunitetit serb.*

II. Seanca plenare (e caktuar për datën 31 mars 2017)

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Shqyrtimi i Propozim - Programit të Punës së Kuvendit të Republikës së Kosovës për vitin 2017,*
- 5. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me Kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike,*
- 6. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë,*
- 7. Zgjedhja e një (1) anëtari të Komisionit të Pavarur për Medie,*
- 8. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me moszbatimi e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës,*
- 9. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaku, të mbështetur edhe nga 8 deputetë tjerë nënshkrues, në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.*

3. Kërkesa e deputetit Bardhyl Meta për mbështetje financiare për shërim jashtë vendit

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Deputeti i Kuvendit të Republikës së Kosovës, z. Bardhyl Meta, mbështetet financiarisht në shumën prej 5 000 € për shërim jashtë vendit.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike: subvencione dhe transfere.

Nënkryetari e mbylli mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 13:30 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit HALITI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale